7100

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT TIRANË

Nr. 7100 Vendimi

# V E N D I M

## PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK TË SHOQËRISË "FORALB ALABASTER" sh.p.k

Sot, më 4 Nënter 1994, në Gjykatën e rrethit Tiranës, para Gjyqtarec ____________________. Gjyqtare e vetme u paraqitkërkesa e kërkue

KËRKUES: SHOQERIA "FORALB ALABASTER" sh.p.k - përfaqsuar nga Administ: teri Idris Çeka i biri i Qerimit dhe i Nexhijes, lindur në Kavaj më 1959 e banues po në Kavaj.

OBJEKTI: REGJISTRIMI SI PERSON JURIDIK TË SHOQËRISË "FORALB ALABASTER" sh.p.k - në bazë të Ligjës 7638 dt.19.11.1992 dhe Ligjës 7667 dt.23.01 1993; si dhe dokumentat e tjera bashkëngjitur dhe;

## K O N S T A T O V A

Me Aktin e Krijimit të Shoqërisë, dt.26.07.1994, me nr.701 kol. dhe nr.668 rep. është vendosur midis Ndërmarrjes "Miniera Krip Gipsit" të Mëngaj në Kavaj dhe Shoqërisë "Aredamenti Leoncini" s.r.l krijimi i Shoqërisë "FORALB ALABASTER" sh.p;K. Sipas Aktit të Krijimit dhe Statutit, kapitali themeltar i shoqërisë është 30.98 milion lekë, i ndarë 23.2 milion nga "Aredamenti Leoncini" s.r.l dhe 7.75 milion nga Ndërmarrja "Miniera Krip Gipsit" Mëngaj.

Kohëzgjatja e Shoqërisë është parashikuar 11 vjetë dhe vendndodhja e saj në Mëngaj të Kavajës. Administrator é Shoqërisë është Idris Çeka. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është parashikuar prodhimi dhe eksportimi i gips-alabastrës dhe prodhimeve prej tyre.

Mbas studimit të Aktit të Krijimit, Statutit dhe akteve që i bashkëngjiten gmoj se kërkesa duhet pranuar.

## PËR KETO ARSYE

Në bazë të Ligjës 7638 dt.19.11.1992" Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit 7667, dt.21.01.1993 " Për regjistrin Tregtar"

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë "FORALB ALABASTËR" e përgjegjësi të kufizuar, e Ortakëve Ndërmarrja "Miniera e krip- ipsit" Mëngaj, ndërmarrje shtetrore dhe "Aredamenti Leoncini" s.r.l e shtetësi Italiane, me kapital themeltar prej 30.98 milion lekë, me Administrator Idriz Çeka, me kohëzgjatje 11 vjet, me vendndodhje në Mëngaj të Kavajës duke patur të drejtë të ushtroj veprimtari pri- vate në rpodhimin dhe eksportimin e gips-alabastër dhe prodhimeve të tyre.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit brenda 10 ditëve.

G J Y Q T A R E

/ /

# STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FORALB-ALABASTER"
sh.p.k ME SELI NE MINIEREN E KRIPES DHE GIPSIT MENGAJ KAVAJE

NENI 1

Shoqeria "FORALB-ALABASTER" sh.p.k. eshte person juridik dhe aktiviteti i saj rregullohet nga dispozitat e Kontrates se Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar, vecanerisht nga Ligji Nr.7638 te dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 2

Shoqeria do te kete objekt te veprimtarise se saj: Prodhimin dhe perpunimin e alabastres dhe gipsit dhe tregetimin per vend dhe per eksport.

Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet e mundshme dhe te patundshme, tregetare, industriale financiare te nevojshme dhe te dobishme per arritjen e objektivitetit te saj.

NENI 3

Shoqeria ka seline e saj ne Republiken e Shqiperise, ne Mengaj te Kavajes ne zyrat e administrates se kesaj miniere. Ajo mund te krijoje filiale dege dhe perfaqesi edhe ne qytetet e tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite strukturore te Shqiperise, deget, filialet e perfaqesite e saj krijohen konform legjislacionit shqiptar dhe legjislacioneve te vendeve ku krijohen.

NENI 4

Shoqeria "FORALB-ALABASTER" sh.p.k. pergjigjet per detyrimet e saj vetem me pasurine e saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve ndaj te treteve. Edhe ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise dhe nuk perballojne humbjet e saj tej pjeseve te kapitalit themeltar qe kane derdhur.

Ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Statuti i shoqerise eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Per detyrimet Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj qe eshte parashikuar ne nenin 37 te ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

ARR. . AMENTI
" LEONCINI ..
TIRANE

Shoqeria eshte e lire te kete marredhenie me persona juridike dhe fizike shqiptare ose te huaj per nje pjese ose per gjithe aktivitetin qe zhvillon.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe kane patur ortaket deri ne fitimin e personelit juridik te saj. Po ashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket mund te krijojne ndaj te treteve jashte aktivitetit te kesaj shoqerie.

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj prodhimin dhe perpunimin dhe tregetimin per vend dhe per eksport.

Shoqeria do te kryeje gjithe veprimet tregetare, financiare qe lidhen me objektin kryesor te veprimtarise se saj dhe qe gjykohen te nevojshme e te dobishme prej saj.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 30.98 milione leke dhe eshte i perbere nga kapitale ne natyre dhe ne para.

Miniera e Kripes dhe Gipsit ne Mengaj te Kavajes kontribon me 7.75 milion leke.

Miratimin shoqeria duhet ta jape brenda tre muajve nga data e njoftimit, perndryshe quhet se miratimi eshte dhene.

Kjo shitje nuk e cliron ortakun nga detyrimet qe ka pranuar perpara ndaj shoqerise dhe nuk pezulion detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.

Ortaku qe shet duhet ne menyre prioritare te ofroje kuoten e tij ortakut tjeter kur ky i fundit nuk pranon ta bleje, mund tua shese kuotat e zoteruara te treteve, por me nje cmimi jo me te ulet se ai qe i ka ofruar ortakut.

Ne cdo rast Asamblea e ortakeve mund te vendose mos shitjen e kuotave te treteve jo te pelqyeshem.

NENI 8

Per te bere te mundur zhvillimin e aktivitetit te shoqerise "FORALB-ALABASTER" sh.p.k., ortaket vene ne dispozicion nje kapital themeltar prej 30.98 milion leke.

Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit te shoqerise me pjeset e treguara ne nenin 5 te kontrates per krijimin e kesaj shoqerie. Ata i kane shlyer pjeset e kapitalit te cilat dokumentohen ne dokumentat bashkengjitur kontrates.

ARREDAMENT
"LEONCINI"
TIRANE

Mandat mbajtesi i shoqerise per terheqjen e fondeve ne para te depozituara ne banke eshte Idriz Çeka.

NENI 9

Kur shoqeria nderpret aktivitein e saj kur ka paguar te gjitha deturimet qe ka marre, shuma e mbetur e kapitalit dhe e fitimit ndahet midis ortakeve ne menyre proporcionale me kuotat qe ata kane vene per te krijuar dhe rritur kapitalin e shoqerise duke zbatuar persa eshte percaktuar ne nenin 6 te aktit te krijimit te kesaj shoqerie.

NENI 10

Shoqeria eshte pronarja e pasurive dhe ka te drejten e perdorimit e te zoterimir te ketyre pasurive, sipas qellimeve e objektivave te aktiviteteve qe ajo kryen.

Shoqeria ka te drejten e mbrojtjes se pasurive ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 11

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fondet e tjera financiare te vecante per zhvilimin e saj, per nxitje ekonomike, te valutes etj.

Nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, le masen ne nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij e cila eshte "rezerve e domosdoshme" e eshte e detyrueshme deri sa rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Shoqeria disponon teresisht mjete te saja financiare.

Detyrimet qe mund te lindin gjate aktivitetit te saj mbulon me pasurine e shoqerise perfshire te gjitha fondet.

NENI 12

Fitimi bruto i shoqerise pas zbritjes te te gjitha shpenzimeve te saj; amortizimin e pasurise se tundshme dhe te patundshme sipas kuotave te percaktuara, te kuotave qe kane te bejne me invesimet, te pagave, te shpenzimeve per lendet e para, per lendet ndihmese, per energjine elektrike, shpenzimet e pergjithshme te reparteve e te shoqerise, tatimet sipas legjislacionit shqiptar pjesa mbetese ndahet midis ortakeve proporcionalisht me kuotat e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise. Kjo behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

Para ndarjes se fitimit hiqet fondi rezerve.

ARRE_AMENTI
LEONCINI
TIRANE

NENI 13

Pasuria e shoqerise vleresohet ne bilancet e saj me vlera te shprehura ne monedhe shqiptare.

Bilanci vjetor i nenshtrohet miratimit te Asamblese se ortakeve brenda nje afati prej 6 muaj duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Forma e bilanceve e te llogarive ekonomike te shoqerise percaktohet nga administratoret, duke mbajtur parasysh edhe formen e bilanceve e te llogarive ekonomike specifike per ndermarrjet industriale, gjithmone duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Cdo vit financiar fillon me 1 janar e perfundon me 31 Dhjetor pervec vitit te pare qe fillon nga momenti i marrjes se personalitetit juridik me 31 Dhjetor.

NENI 14

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e ortakeve.

Bejne pjese ne te ortaket qe kane te drejten e votes proporcionalisht me madhesine e shumave te kapitalit te derdhur.

Vendimet e Asamblese te marra ne perputhje me ligjin, aktin themelues dhe me kete statut jane te detyrueshem per ortaket edhe kur nje nga ortaket ka votuar kundra.

Cdo ortak ka te drejten e votes sipas perqindjes se kapitalit themeltar.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar, nga administratoret, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesi.

Sipas rendesise se problemeve mbledhja e Asamblese mund te vendose:

1. Me mbi 50% te pjeseve te kapitalit themeltar per:

   * Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

   * Emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorzuar dhe likuiduesve.

   * Miraton raportin e administrimit dhe te kontrollit.

   * Miraton llogarite vjetore dhe ndarjen e fitimit.

ARREDAMENTI LEONCINI TIRANE

2. Me mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar per:

* Ndryshimet ne statut.

* Zvogelimin e kapitalit themeltar.

* Transformimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet.

* Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimin e saj.

* Shndrrimi i sh.p.k. ne shoqeri anonime.

NENI 15

Organi administrativ i shoqerise jane administratoret.

Administrator i shoqerise ne formim e siper eshte emeruar me unanimitet te ortakeve z.Idriz Çeka.

Asamblea e ortakeve ne mbledhjen e pare te saj emeron administratoret, te cilet qendrojne ne fuqi per nje kohe jo me te gjate se 3 vjet por mund te rizgjidhen.

Asamblea e ortakeve ka te drejten qe ne cfaredo kohe te heqe nga detyra nje ose te dy administratoret me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Administratoret shkarkohen nga detyra vetem per shkaqe qe i sjellin dem shoqerise.

NENI 16

Kompetencat e administratoreve ne menyre te permbledhur por perfundimtare jane:

* Formulojne bilancet dhe llogarite ekonomike.

* Ndryshojne aktivitetet e prodhimit qe realizohet dhe te aktiviteteve qe duhet te kryhen, qe bejne pjese ne objektin shoqeror te shoqerise.

* Percaktojne raportet qe egzistojne brenda shoqerise, perfshire edhe personelin.

* I propozojne Asamblese se ortakeve per ndryshime mbi kapitalin e shoqerise.

* Percaktojne regjimin e kushteve te zbatimit te llogarive ekonomike e te bilancit.

ARR... AMENTI · LEONCINI ·· TIRANE

* Propozojne ne Asamble per krijim filialesh, degesh apo perfaqesi.

* Perzgjedhin anetaret e komosionit te likuidimit.

* Pergatitin propozime per nderprerje te aktivitetit te shoqerise.

* Firmosin dhe perfaqesojne shoqerine perballe te treteve.

* Percaktojne organiken dhe ndarjen e vendeve drejtuese.

* Krijojne organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.

* I paraqitin propozime Asamblese se ortakeve per rregullimin, krijimin e fondeve te vecanta, ndarjen e fitimeve si dhe percaktojne rregullat per te shlyer debitet.

* Ndjekin zbatimin e vendimeve te Asamblese se ortakeve.

Asamblea e ortakeve njerit prej administratoreve mund t'i caktoje kompetenca me te shumta se tjetrit.

Administratoret mbajne pergjegjesi solidare per veprimet dhe vendimet qe marrin.

NENI 17

Organ kontrolli i shoqerise eshte eksperti kontabel i automatizuar. Ai emerohet nga Asamblea e ortakeve me me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Ai caktohet per 6 (gjashte) vite financiare. Eksperti kontabel i autorizuar duhet te plotesoje kerkesat e nenit 168 dhe 169 te ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Ekspertet kontabel te autorizuar garantojne qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta dhe te hartuara me singeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit financiar si dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Ne menyre te permbledhur ekspertet kontabel te autorizuar kryejne keto detyra:

* Verifikojne librat e llogarise si dhe fondet e shoqerise.

* Kontrollojne pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi.

* Verifikojne perputhjen me llogarite vjetore te informacionit e te dhena ne raportin e administrimit.

ARH... AMENTI
LEONCINI ..
TIRANE

* Ne cdo kohe ata kontrollojne gjithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve.

* Mund te aktivizojne ekspertet ose bashkepunetoret e tyre per te perballuar volumin e punes, por duhet te miratohet nga Asamblea.

* Mbledhin informacione te dobishme per ushtrimin e detyres, u bejne te treteve qe kane kryer operacione per llogari te shoqerise.

* Ekspertet kontabel te autorizuar u bejne te njohur Asamblese dhe administratoreve:

1. Kontrollet dhe verifikimet qe kane kryer si dhe sondazhet e ndryshme qe kane bere.

2. Pjeset e bilancit dhe te dokumenteve te tjera te kontabilitetit ne te cilat sipas tyre duhet te ishin bere ndryshime, duke bere gjithashtu edhe verejtjet e duhura mbi metodat e vleresimit te perdorura ne perpilimin e ketyre dokumenteve.

3. Parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

4. Perfundimet qe rrjedhin nga verejtjet dhe korrigjimet e siperme mbi rezultatet e vitit financiar te krahasuara me ato te vitit financiar te meparshem.

Ekspertet kontabel te autorizuar marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se ortakeve.

Bejne denoncime ne prokurori per faktet qe perbejne krim.

Ruajne si sekret profesional faktet dhe informacionet per te cilat jane vene ne dijeni per shkak te funksioneve te tyre.

Jane pergjegjes para shoqerise ose te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleresimet e tyre ne ushtrimin e funksioneve te tyre.

NENI 18

Marredheniet e punes ne shoqeri, filiale, dege ose perfaqesi rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Per rastet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen disporitat e legjislacionit shqiptar.

NENI 19

Aktiviteti i shoqerise zgjat 11 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykate ose me shpejt ose me vone, sipas

ARH AMENTI
LE ONCINI ..
TIRANE

propozimit te bere nga nje prej ortakeve aprovuar nga Asamblea e ortakeve me shumicen e parashikuar ne nenin 60 te ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992.

Per cfaredo rasti qe nuk rregullohet me kontraten e me statutin e shoqerise, aplikohen normat e Ligjit 7638/1992 qe ka beje me shoqerite me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 20

Cfaredo mosmarreveshje midis ortakeve qe nuk mund te zgjidhen brenda shoqerise edhe pse Asamblea mblidhet dy here do te zgjidhet nga Gjykata e Kavajes ne perputhje me rregullat proceduriale te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

NENI 21

Ky statut perbehet nga 21 nene, u reduktua ne 5 ekzemplare ne gjuhen shqip dhe italisht, duke patur te dy tekstet vlere te barabarte.

**Ortaket**

Miniera e Kripes dhe e Gipsit
Mengaj-Kavaje

Drejtori

Idriz Çeka

"Aradamenti Leonçini"

Presidenti

Enea Leonçini

ARREDAMENTI
"LEONCINI"
TIRANE

Kavaje me 26/7/1994.